V E N D I M
Nr. 392, datë 15.8.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR RROGOZHINË-ELBASAN NË QARKUN E ELBASANIT

(Ndryshuar me VKM nr. 430, datë 2.7.2004)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrogozhinë-Elbasan në Qarkun e Elbasanit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme të cilët shpronësohen të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe 14 604 m2 tokë arë, 4 objekte të ndryshme me sipërfaqe 248 m2, 56 m/l mure rrethuese, një pus uji, 90 m2 servis mekanik, 54.2 m2 magazinë bujqësore, 36 m2 godinë në ndërtim, 189.73 m2 objekt klinik dhe banesë 3 katëshe+nënçati, 1 118 rrënjë drurë frutorë dhe 728 m2 rozmarinë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 49 426 358 (dyzet e nëntë milionë e katërqind e njëzet e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekësh.

3/1. Pronari i pasurisë së paluajtshme shtesë "Alba Posta", që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, e cila paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe ndërtimore 90 m^2, sipas certifikatës së pronësisë me nr.730, datë 21.11.2001, me çmimin e dhënë nga Enti Kombëtar i Banesave prej 23 962 lekë/m^2, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 156 580 (dy milionë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale është në shumën 815 000 (tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

5. Fondi prej 50 241 358 (pesëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

5/1. Fondi prej 2 156 580 (dy milionë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekësh, për kompensimin e pronarit të "Alba Posta", të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Komunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.8.2002.

6/1. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.7.2004.

7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Drejtoria Juridike

LISTA E PRONARIT QE SHPRONESOHET PER EFEKT TE NDERTIMIT TE

SEGMENTIT RRUGOR RROGOZHINE-ELBASAN

Nr	Pronari	Numri i pasurise	OBJEKT			Shenime
			Siperfaqe e shpronesuar	Çmimi leke/m2	Vlera leke	
1	Alba Posta Sh.A Pajove	182/28	90 m2	23 962	2 156 580	

Mbyllet me nr. rendor 1

(Shtuar me VKM nr. 430, datë 2.7.2004)